



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË MINISTRISË SË INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE  
TREGTISË PËR VITIN 2021**

**Prishtinë, qershor 2022**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Vlera e pasurisë kapitale e prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 431,104€, përderisa në anën tjetër vlera e pasurisë kapitale dhe jokapitale ishte nënvlerësuar për 49,287€.
- A2 Gjatë vitit 2021, MINT ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 150,000€ në kategori ekonomike jo adekuate.
- B1 MINT gjatë vitit 2021 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 127,008€ për 25 punonjës (të angazhuar me Marrëveshje të Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmërinë në punë dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MINT kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi

dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Në kontekst të sistemeve financiare, duhet të forcohen kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë dhe shpenzimet jo racionale. Kategoritë ku nevojiten më shumë përmirësime janë mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale si dhe menaxhimi i pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja dhe tri (3) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Prezantimi jo i plotë i pasurisë

##### Gjetja

Sipas nenit 6.3 të rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare – Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria. Po ashtu, neni 6 i rregullores së MF - Nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore përcakton që "Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare". Më tej neni 12, thekson se - Organizatat mund të blejnë dhe ndërtojnë pasuri përmes bashkëfinancimit dhe deri në momentin e pranimit të pasurisë jofinanciare, ato do të regjistrojnë në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jofinanciare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e OB, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e OB-së pranuese dhe OB-së bashkë-financuese. Pasuria më pas regjistrohet në regjistrin e pasurisë së OB-së pranuese..

Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Shtatë (7) pagesa në vlerë 431,104€ për projektin "Ndërtimi i infrastrukturës fizike të parkut industrial në Qylagë-Lipjan" të realizuara përmes bashkëfinancimit me komunën e Lipjanit, ministria vazhdon t'i mbajë si investime në vijim në regjistrin e pasurisë edhe pse projekti kishte përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik nga komisioni përkatës i komunës, si dhe
- Vlera e pasurisë kapitale dhe jokapitale e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 49,287€. Auditimi ka nxjerrë në pah se katër<sup>4</sup>(4) pagesa për investime kapitale në vlerë prej 3,463€ nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së, si dhe pesë<sup>5</sup>(5) pagesa në vlerë 45,824€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Kjo kishte ndodhur në mungesë të angazhimit të zyrtarit të pasurisë si dhe funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurisë dhe mbajtja e projekteve të përfunduara në regjistrin e pasurisë si investime në vijim ndikon në prezantim jo të drejtë të pasurive në PFV dhe pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë dhe rrit rrezikun që pasuritë të humbin apo keqpërdoren.

**Rekomandimi A1** Ministria duhet të ndërmarrë veprime për të siguruar regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë. Po ashtu të sigurojë se projektet e financuara për komuna për të cilat janë bërë pranimet teknike nga komuna e të cilat i kanë nën administrim këto pasuri, përmes procedurave formale të bëj bartjen e pronësisë dhe në të njëjtën kohë të largoj nga regjistrat e pasurisë së ministrisë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve**

**Gjetja** Sipas nenit 18 pikës 3 të rregullës financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në një<sup>5</sup> rast kemi vërejtur se MINT ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 150,000€ në kategorinë ekonomike jo adekuate. Ky shpenzim për nga natyra i takon kategorisë subvencione dhe transfere, ndërsa ishte paguar/regjistruar në kategorinë mallra dhe shërbime.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

**Ndikimi** Pagesat e kryera nga kategoria ekonomike jo adekuate ka ndikuar në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar Informata të gabuara për lexuesin e PFV-ve.

**Rekomandimi A2** Ministria duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B1 - Kompensim i punonjësve pa vijueshmëri në punë**

**Gjetja** Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve”, përcakton se “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik”.

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduar të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur "Mbrojta Civile". Përmes këtij vendimi, MINT ka të angazhuar 25 punonjës të komunitetit serb me qëllim të integritit të tyre në sistemin e Republikës së Kosovës. Këta punonjës nuk kanë punuar asnjëherë për MINT që nga viti 2016 kur edhe janë nënshkruar aktemrimet e tyre. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2021 ishte 127,008€, edhe pse për të njëjtit nuk ka dëshmi të vijimësisë në punë.

Mungesa e hapësirave të punës në komunat përkatëse ishte shkak kryesor për mos angazhimin e këtyre të punësuarve.

**Ndikimi**

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmime për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

**Rekomandimi B1**

Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2021 ishte 2,553,280€, prej tyre ishin shpenzuar 1,569,008€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, blerje për rezerva shtetërore, shpenzime të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, dreka zyrtare dhe shpenzime tjera operative.

#### **Çështja B2 - Realizimi i shpenzimeve të telefonisë në mungesë të kontratës valide**

##### **Gjetja**

Rregulla Financiare 01/2013 e MF-së për Shpenzim të Parasë Publike, neni 26, obligon të gjitha autoritetet publike, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, se asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e ligjit LMFPP.

Gjatë testimit të pagesave për shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobile kemi konstatuar se MINT kishte realizuar pagesa në mungesë të kontratës valide duke u bazuar në vendimin e Qeverisë me nr.05/21 i dt.02.04.2020, vendim i cili e përjashton nga fushëveprimi i LPP-së shërbimet telekomunikuese që ofron 'Telekomi i Kosovës Sh.A' si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore. Mirëpo ky vendim është shfuqizuar me vendim të Qeverisë nr.05/34 të datës 07.10.2020 që i obligon të gjitha OB që t'i ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e LPP-së.

MTI gjatë vitit 2021 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 20,374€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos lidhjes së kontratës së re nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

##### **Ndikimi**

Pranimet e shërbimeve pa mbështetje në dokumente ligjore, siç është kontrata, mund të shkaktojnë pranim të shërbimeve të pafavorshme dhe jo në përputhje me çmimet e tregut.

##### **Rekomandimi B2**

Ministrja në bashkëpunim me MPB-në të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,858,821€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 771,982€. Ato kanë të bëjnë me realizimin e projekteve kapitale, si: ndërtimi i zonave ekonomike, ndërtimi i parqeve të biznesit, ndërtimi i parqeve industriale, zhvillimi i fushave të reja të metrologjisë, inkubatorët e biznesit dhe disa projekte tjera.

### Çështja A3 - Vonesat në realizimin e punimeve

**Gjetja** Në kontratat e nënshkruara ndërmjet MINT dhe operatorëve ekonomik për realizimin e projekteve kapitale përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve sipas kontratës.

Ne kemi identifikuar dy(2) raste ku punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë. Punimet që duhet të përfundonin brenda vitit 2020 dhe 2021, deri në përfundim të auditimit (data 06.04.2022) ende nuk kishin përfunduar në këto projekte:

- Ndërtimi i infrastrukturës në Parkun Industrial në Budrikë- Viti, vlera e kontratës 1,774,712€ e datës 09.11.2018 duhej të përfundonte brenda 250 ditë pune; dhe
- Ndërtimi i Inkubatorit të Biznesit në Malishevë, vlera e kontratës 271,172€ e datës 08.04.2019 duhej të përfundonte brenda 100 ditë pune.

Sipas zyrtarëve të ministrisë arsyeja e vonesave në realizimin e këtyre projekteve ishte paraqitja e nevojës për ndryshime dhe punë shtesë si rezultat i planifikimit jo të mirë të tyre.

**Ndikimi** Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që MINT të mos arrijë objektivat e përcaktuara dhe njëherësh mund të shkaktoj vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

**Rekomandimi A3** Ministrja duhet të sigurojë se para inicimit të procedurave tenderuese kryhen analiza të detajuara për projektet përkatëse në mënyrë që realizimi i tyre të mos pësojë ndryshime prej planit. Po ashtu, ministrja duhet të sigurojë përmes stafit përkatës një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të papërfunduara. Më tutje të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që punimet të realizohen sipas planit dinamik të kontraktuar.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale.

#### Çështja A4 - Ndarja e tenderëve për punë të njëjta

**Gjetja** Sipas nenin 5.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, AK për të planifikuar aktivitetet e prokurimit duhet të mbledhë kërkesat, kur është e mundshme (të njëjta ose të ndërlidhura), për të fituar vlerën për parandë dhe për të reduktuar kostot e prokurimit.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se në 12<sup>e</sup> procedura të prokurimit në vlerë prej 14,807€, ministria kishte aplikuar ndarje të tenderëve për punë të njëjta, duke përdorur procedurën e kuotimit të çmimit, si dhe vlerën minimale.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kërkesave të shumta nga njësi kërkuese të ndryshme për furnizime të cilat nuk ishin të planifikuara.

**Ndikimi** Mos aplikimi i një procedure të vetme të prokurimit për kërkesat e njëjta/ngjashme mund të rezultojë me një kosto më të lartë të shpenzimeve sesa çmimet e konkurrencës.

**Rekomandimi A4** Ministrja duhet të sigurojë që planifikimi i prokurimit bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet menaxherit të prokurimit me njësitë kërkuese për të diskutuar kërkesat e tyre me kohë për prokurim, në mënyrë që të ketë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 15,079,632€, pasurive jokapitale është 88,464€, si dhe e stoqeve është 2,151€.

### Çështja B3 - Mos-harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistra të pasurisë

**Gjetja** Sipas nenit 18.1 të rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore "Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare". Ndërsa neni 19 paragrafi 4.3 i përcakton që: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe "Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare."

Në MINT është bërë inventarizimi i pasurisë për vitin 2021, komisioni ka përpiluar një raport gjithëpërfshirës mirëpo nuk ka bërë harmonizimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe se raportimi i pasurive në PVF ishte bërë sipas regjistrave kontabël.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdorën, humben apo të tjetërsohen, si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e plotë dhe e saktë.

**Rekomandimi B3** Ministrja duhet të sigurojë që komisioni për inventarizimin e pasurisë pasi të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, duhet të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme, dhe se e gjithë kjo të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2022.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>7</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>8,882,233</b>	<b>27,465,964</b>	<b>14,012,257</b>	<b>7,065,092</b>	<b>7,671,267</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	6,312,590	18,566,828	13,685,355	5,840,642	6,950,444
Financimi përmes huamarrjes	1,069,643	7,399,136	326,901	525,186	167,748
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	1,500,000	1,500,000	0	0	59,700
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	699,264	493,375

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 18,583,731€. Kjo rritje është rezultat i fuzionimit të dy departamenteve nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

Në vitin 2021 ministria ka shpenzuar 51% të buxhetit përfundimtar ose 14,012,257€, me një ulje prej 14% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>8,882,233</b>	<b>27,465,964</b>	<b>14,012,257</b>	<b>7,065,092</b>	<b>7,671,267</b>
Pagat dhe mëditjet	1,848,692	1,908,036	1,906,700	1,858,722	1,663,711
Mallrat dhe shërbimet	2,324,261	2,474,000	1,530,090	1,805,730	2,058,638
Komunalitë	109,280	79,280	38,919	41,785	67,475
Subvencionet dhe transferet	1,780,000	20,145,826	9,764,566	1,279,224	1,313,803
Investimet Kapitale	2,820,000	2,858,821	771,982	2,079,631	2,567,640

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar, ishte rritur për 59,344€, si rezultat i rishikimit të buxhetit ishte rritur për 182,740€ dhe ishte zvogëluar me vendimin e Qeverisë për kursime dhe ndarje në vlerë për 123,396€. Shpenzimi ishte 100% e buxhetit
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar, kishte rritje për 149,739€, si rezultat i rishikimit të buxhetit ishte rritur për 730,918€ dhe ishte zvogëluar me vendimet e Qeverisë për kursime, harmonizime dhe ndarje në vlerë për 577,815€. Shpenzimi ishte 62% e buxhetit final;
- Buxheti final për shërbime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 30,000€. Me rishikim të buxhetit ishte rritur për vlerën 11,655€ ndërsa me vendim të Qeverisë për kursime dhe ndarje ishte zvogëluar në vlerë për 41,655€. Shpenzimi ishte 49% e buxhetit;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 18,365,826€. Buxheti kishte rritje si rezultat i rishikimit buxhetor në vlerë prej 31,977,420, ndërsa ishte zvogëluar si rezultat i Vendimit të Qeverisë për kursime dhe ndarje për 13,611,594€. Shpenzimet ishin 48.47% e buxhetit, realizimi i ultë i buxhetit në këtë kategori kishte ndodhur për shkak se pjesa dërmuese e këtyre mjeteve kanë qenë të dedikuara për Pakon e Ringjalljes ekonomike për të cilën ministria ka pas vështirësi për ta realizuar sepse nuk janë ofruar informatat e sakta nga ana e përfituesve (bizneseve).
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte rritur për 38,821€. Me rishikim të buxhetit ishte rritur për vlerën 346,393€, ndërsa ishte zvogëluar si rezultat i Vendimit të Qeverisë për kursime dhe harmonizime për 307,572€. Shpenzimi i buxhetit në këtë fushë ishte 27%, realizimi i ultë i buxhetit në këtë kategori kishte ndodhur për shkak të mosrealizimit të projekteve " Krijimi i sistemit e- inspektive" dhe "Krijimi i ndërveprimit të inspektiveve dhe avancimi i bazave të të dhënave që ndërlidhen me inspektimet në ministritë dhe agjencitë relevante", të cilat kanë qenë të ndërlidhura, dhe kanë qenë të varura nga aprovimi i Ligjit për Inspekcione, i cili Ligj është aprovuar në Dhjetor të vitit 2021.
- Ministria gjatë vitit për menaxhim të pandemisë COVID 19 kishte shpenzuar 3,833€ (alkool dhe maska) nga kategoria mallra dhe shërbime.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Ministria në 2021 ishin në vlerë 2,483,017. Këto të hyra kanë të bëjnë me regjistrimin e pengut, pronësisë industriale, të hyrat nga licenca për shërbime profesionale, licenca për importimin e naftës, licencat për importin e duhanit, të hyrat nga qiraja dhe të hyrat tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>2,551,720</b>	<b>2,203,753</b>	<b>2,483,017</b>	<b>1,912,701</b>	<b>1,998,924</b>
Të hyrat jo tatimore	2,551,720	2,203,753	2,472,796	1,904,553	1,998,924
Të hyrat tjera	0	0	10,221	8,148	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të MINT ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime kryesore. MINT kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tri (3) rekomandime janë zbatuar, si dhe tri (3) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve). (Vëni re se kur çeket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit – deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të komunitetit serb, duke bërë monitorimin e tyre të vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore.	Kjo çështje nuk ishte zgjidhur as në vitin 2021.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja në bashkëpunim me MPB-në të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve..	Edhe në vitin 2021 janë pa identifikuar pa rregullësi të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Investimet	Ministrja duhet të sigurohet se specifikat	Nuk kemi	I zbatuar



	kapitale	teknike janë hartuar në harmoni me projektet ekzekutive dhe aprovimet e ndryshimeve duhet të behën vetëm për rastet e lejuara me ligj. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme dhe në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.	identifikuar çështje të ngjashme	
4.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive në çdo kohë. Më tutje, pas përfundimit të raportit të inventarizimit, të ndiqen proceset tjera përkatëse për harmonizim të regjistrave të pasurive para përgatitjes së PFV-ve me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar pa rregullësi të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pasuritë	Ministrja duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të bëhet azhurnimi i regjistrit të aseteve duke larguar automjete të cilat nuk janë pronë e ministrisë që nga viti 2014.	Këto vetura janë larguar nga regjistrat.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Për tu llogaritur në mënyrë të drejtë dhe të saktë zhvlerësimi i pasurive, Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha blerjet të regjistruhen sipas kategorive të klasifikuara në bazë të rregullores përkatëse.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

	
<p><b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b> <b>Qeveria-Vlada-Government</b></p>	
<p><i>Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë</i> <i>Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade</i></p>	
<p><b>LETËR E KONFIRMIMIT</b></p>	
<p>Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve</p>	
<p>Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit Të nderuar, Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:</p>	
<ul style="list-style-type: none"><li>• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");</li><li>• pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe</li><li>• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.</li></ul>	
<p>Znj. Rozeta Hajdari, Ministre në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë</p>	
  Data: Qershor 2022, Prishtinë,	

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>8</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>9</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

**Shënimet fundore**

- 1 Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- 2 Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- 3 Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- 4 -Ndërtesa administrative 548€; ndërtesa administrative 989€; ndërtesa administrative 938€; ndërtesa administrative 988.28€;  
- Kompjutera në vlerë 24,382€; montimi i kamerave vlera 18,936€; pajisje tjera 400.92€; mobile 1,215€ dhe TV samsung 890€.
- 5 Në kategorinë mallra dhe shërbime kemi identifikuar që MTI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me ECIKS ShPK për implementimin e projektit Iniciativa për Fuqizim Digjital i cili përkrahet nga “Qasja në Treg dhe Shërbimet e Digjitalizimit për Bizneset Kosovare” (ACCESS) në vlerë 150,000 Euro.
- 6 Renovimi i disa zyreve brenda objektit të MTI-së, vlera 4,195.75€; Renovimi dhe ndarja e zyreve në Departamentin e Investimeve Strategjike, vlera 2,199.00 €; Ndarja e Zyrës së Kryeinspektorit nga Zyra e Inspektoratit të tregut, vlera 989€; Rregullimi i Zyrës së Auditorëve të Brendshëm, vlera 988.28€; Furnizimi dhe montimi me TV ne nevojat e sallës së takimeve MINT, vlera 890€; Furnizimi me një TV për Kabinetin e Ministres, vlera 1,077€, Furnizim dhe montimi i perdeve në zyret e AKS-së, vlera 539.60€; Furnizim dhe montimi i perdeve shiritore në Kabinetin e ministres, vlera 240€; Furnizim me perde për kabinetin e MINT, vlera 825.30€; Furnizim me maska për nevojat e MTI-se, vlera 980€; Furnizim me maska dhe alkool, vlera 935€, si dhe Furnizim me maska dhe alkool për nevojat e MINT 948€.
- 7 Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- 8 Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- 9 Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.